

Disa njerëz mund të kenë nevojë për vaksina shtesë



Disa njerëz kanë më shumë mundësi që të vuajnë nga sëmundje të rënda nga infeksionet dhe duhet t'u ofrohen vaksina shtesë për t'i ndihmuar. Kjo përfshin njerëzit që jetojnë me një sëmundje kronike që prek organet e tyre kryesore ose sistemin e tyre imunitar.



Hepatiti A Vaksina nevojitet për personat që kanë rrezik të lartë për hepatitin A duke përfshirë ata me sëmundje mëlçie dhe familjet ku është raportuar një rast i tillë.



Hepatiti B Vaksina shtesë e hepatitit B disponohet edhe për personat me sëmundje mëlçie ose ata që kanë mundësi të lartë që ta marrin infeksionin (p.sh. bebet e lindura nga nëna me hepatit B ose personat që kanë një partner ose anëtar familjeje me këtë infeksion). Pyesni te klinika e mjekut tuaj të përgjithshëm nëse ju ose fëmija juaj duhet të marrë vaksinën e hepatitit B.



Tuberkulozi Vaksina BCG nevojitet nga fëmijët dhe të rriturit që jetojnë në zona me norma të larta tuberkulozi. Edhe personat me anëtarë të afërt të familjes me tuberkuloz, kanë nevojë për vaksinën BCG.

Për informacion në lidhje me udhëzimet aktuale të regjistrimit të NHS-së (Politika e kujdesit parësor shëndetësor dhe Manuali i udhëzimeve) si dhe për udhëzuesin e përgjithshëm të BMA-së për nevojat shëndetësore të emigrantëve, ju lutemi vizitoni: <https://bit.ly/2hv37zc>



Unë kam të drejtën të regjistrohem
dhe të marr trajtim nga klinika
e mjekut të përgjithshëm

A jeni i sëmurë ju ose dikush për të cilin kujdeseni?



Telefononi NHS-në në numrin 111 nëse keni nevojë urgjente për ndihmë ose këshillë mjekësore, por kur situata nuk është kërcënuese për jetën. Ju mund të telefononi gjithashtu NHS-në në numrin 111 nëse nuk jeni i sigurt se për cilin shërbim të NHS-së keni nevojë.



Pyesni farmacistin lokal për këshilla – farmacisti mund t'ju japë këshilla për shumë sëmundje të vogla të zakonshme, si diarreja, infeksionet e vogla, dhimbja e kokës, këshilla për udhëtimet ose dhimbjet e fytyrës.



Lini një takim me mjekun e përgjithshëm nëse nuk ndiheni mirë dhe nuk është rast urgjence.



Vizitoni një qendër që pranon vizita pa lënë takim, një qendër të lëndimeve të vogla ose një qendër të kujdesit të shpejtë jo-urgjent nëse keni sëmundje ose lëndime të vogla (prerje, ndrydhje ose ekzema) dhe nëse situata nuk mund të presë derisa të hapet klinika e mjekut tuaj të përgjithshëm.



Telefononi numrin 999 nëse dikush është i sëmurë rëndë ose i plagosur rëndë dhe e ka jetën në rrezik.



Departamenti i A&E (i njohur gjithashtu edhe si departamenti i urgjencave ose aksidenteve) trajton urgjencave reale kërcënuese për jetën. Pacientët vizitohen dhe trajtohen sipas shkallës së nevojës.



UK Health
Security
Agency

© Të drejtat e autorit 2022, Crown. MG235589 1P DEC 2019 (APS)
UK Health Security Agency gateway number: 2019230



UK Health
Security
Agency



Të transferuar në Mbretërinë e Bashkuar:

Përditësoni vaksinat tuaja



Vaksinat janë mënyra më e sigurt për t'ju mbrojtur juve dhe familjen tuaj nga infeksionet e rënda, ato ju ndihmojnë të qëndroni të shëndetshëm



Në Angli, shumica e vaksinave ofrohen falas në NHS. Vaksinat mund t'ju mbrojnë gjatë gjithë jetës. Për t'ju mbrojtur fëmijët sa më herët të jetë e mundur, shumë vakcina u ofrohen bebeve dhe fëmijëve të vegjël përpara se të fillojnë shkollën. Duke qenë se vaksinat janë të pranueshme gjerësisht në Angli, ato nuk janë të detyrueshme.



Vaksinat zakonisht bëhen nga infermieret e klinikës së mjekut të përgjithshëm. Infermieret e klinikës janë të trajnuar veçanërisht për të dhënë këshilla dhe për të ofruar vaksinat. Infermierja do të kontrollojë me kujdes kartelën tuaj shëndetësore, por për sa kohë që ju ose fëmija juaj jeni mirë, nuk nevojitet kontroll nga mjeku.

Fëmijëve më të mëdhenj u ofrohen disa vakcina në shkollë. Vaksinat për të rriturit normalisht ofrohen në klinikën e mjekut të përgjithshëm ose në farmaci.



Nëse nuk jeni i sigurt nëse ju ose fëmija juaj i ka bërë të gjitha vaksinat që rekomandohen në Angli, këshillohuni me klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm. Nuk është asnjëherë shumë vonë që të plotësoni vaksinat e mbetura që rekomandohen në Angli.

Regjistrimi pranë një klinike të mjekut të përgjithshëm

Kushdo në Angli mund të regjistrohet pranë një klinike të mjekut të përgjithshëm dhe të vizitohet FALAS te një mjek ose infermiere e kujdesit parësor. Nuk është nevoja të paraqisni vërtetime të identitetit ose të statusit të emigracionit për t'ju regjistruar pranë një klinike të mjekut të përgjithshëm.

Kjo aplikohet gjithashtu edhe nëse jeni azilkërkuar, refugjat, pacient i pastrehë apo vizitor nga jashtë vendit, qoftë i ligjshëm apo jo në Mbretërinë e Bashkuar.

Ju duhet të regjistroheni edhe nëse gëzoni shëndet të plotë. Nuk i dihet asnjëherë se kur mund t'ju nevojitet kujdes shëndetësor dhe klinika mund të ofrojë shërbime parandaluese për t'ju mbajtur të shëndetshëm.



Nëse ju nevojitet një shoqëruar ose një përkthyes, pyesni te klinika e mjekut të përgjithshëm.

Të gjithë në Angli duhet të regjistrohen me një mjek të përgjithshëm. Atje mund të vizitoheni falas dhe nuk është nevoja të jepni vërtetime të adresës suaj

Detajet mbi mënyrën e regjistrimit pranë një mjeku të përgjithshëm mund t'ju gjeni në këtë fletëpalosje dhe në www.nhs.uk/using-the-nhs/nhs-services/gps/how-to-register-with-a-gp-practice

Për disa trajtime në NHS mund t'ju duhet të paguani, por vaksinat rutinë janë falas.

Çfarë duhet të bëni nëse keni probleme me aksesin në kujdesin shëndetësor?

Nëse vazhdoni të keni probleme, telefononi numrin 111.

Vende të ndryshme ofrojnë vakcina të ndryshme

Është mirë që të këshilloheni me klinikën e mjekut tuaj të përgjithshëm dhe të siguroheni që keni bërë të gjitha vaksinat që ofrojmë falas këtu në Angli. Nuk ka rëndësi pse nuk i keni bërë, është e rëndësishme që t'i bëni ato që ju kanë mbetur dhe të mbroheni.

Disa infeksione mund të jenë më të zakonshme në vende të tjera, prandaj është gjithashtu e rëndësishme që të kontrolloni nëse ju nevojiten vakcina shtesë përpara se të udhëtoni jashtë vendit për të vizituar familjen dhe miqtë, disa vakcina udhëtimi nuk janë falas te NHS.



Kur jepen vaksinat në mënyrë rutinë në Angli dhe cilat janë këto vakcina?



Vaksinat u ofrohen fëmijëve të sapolindur, fëmijëve më të mëdhenj, adoleshentëve, grave shtatzëna dhe të moshuarve. Më shumë rreth programit të vaksinimit mund të gjeni këtu www.nhs.uk/conditions/vaccinations. Nëse keni lënë pa bërë ndonjë vaksinë që përmban programi i Mbretërisë së Bashkuar, mund të keni ende nevojë për mbrojtje, edhe në moshë të madhe. Kërkojini mjekut të përgjithshëm ose infermieres që të kontrollojë nëse ju nevojitet një dozë shtesë.



Bebet ose fëmijët e vegjël kanë nevojë për vaksinat që t'ju mbrojnë nga infeksionet e fëmijërisë, si p.sh. fruthi, shytat, rubeola (MMR), rotavirusi, difteria, kolla e mirë, meningjiti, poliomieliti, tetanozi, hepatiti B, tuberkulozi etj.




Fëmijët e moshës parashkollore kanë nevojë për vakcina suplementare për disa prej sëmundjeve të listuara më lart. Kjo i ndihmon fëmijët që të mbrohen më mirë dhe për një kohë më të gjatë. Fëmijëve të shkollës fillore u ofrohet vakcina e gripit çdo vit.



Adoleshentët kanë nevojë edhe për një vaksinë tjetër suplementare për disa prej këtyre infeksioneve, duke përfshirë meningjitin, për të pasur mbrojtje afatgjatë deri në moshë të rritur. Atyre u ofrohet gjithashtu edhe vakcina HPV e cila mund të parandalojë disa kancere.



Nëse po planifikoni të lindni fëmijë, duhet të kontrolloni nëse i keni bërë të gjitha vaksinat, veçanërisht dy dozat e MMR-së, përpara se të mbeten shtatzënë.



Nëse jeni shtatzënë ju nevojiten vakcina për t'ju mbrojtur juve dhe fëmijën tuaj nga kolla e mirë dhe gripi. Gjithashtu duhet të bëni kontroll (të bëni analiza gjaku) për infeksione të tilla si hepatiti B që mund të kalohet nga nëna te fëmija. Disa bebe mund të kenë nevojë për një vaksinë shtesë të hepatitit B kur lindin.



Të moshuarit kanë nevojë për vakcina që të mbrohen nga gripi, pneumonia dhe herpes zoster.

Flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm ose infermierin e klinikës për të parë nëse ju ose fëmijët tuaj keni nevojë për vakcina rutinë apo vakcina shtesë.